



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - Ministarstvo Inostranih Poslova i Diaspore  
Ministry of Foreign Affairs and Diaspora

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës shpall:

## Konkurs

### Lëvizje brenda kategorisë

*Të drejtë për aplikim në këtë procedure kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.*

<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme
<b>Klasa e pozitës</b>	Profesional 1
<b>Koeficienti/Paga</b>	5.75
<b>Nr. i kërkuar</b>	1
<b>Data e njoftimit</b>	27/06/2023
<b>Afati për aplikim</b>	12/07/2023 - 19/07/2023
<b>Institucioni</b>	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
<b>Departamenti</b>	Divizioni për Teknologji Informativë
<b>Divizioni</b>	
<b>Vendi i punës</b>	MPJD
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00011937
<b>Kodi</b>	RPC0005530



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

- Instalimin, migrimin dhe back-up e bazave të të dhënave dhe aplikacioneve;
- Krijon dhe konfiguron bazat e të dhënave në SQL server, ku përfshihen kapaciteti, rrjeti, grupet e fajllave (filegroups) dhe optimizon performancat;
- Administron dhe mirëmban bazat e të dhënave si dhe përgatit dhe implementon politikat për siguri të bazave të të dhënave;
- Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e projekteve, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën administrimit të bazave të të dhënave;
- Krijon dhe mirëmban kopjen rezerve (backup) dhe përgatit procedurat për restaurimin e tyre (skenarët për backup dhe restore);
- Është përgjegjës për dizajnimin, zhvillimin dhe kontrollin e kualitetit të bazave të të dhënave si dhe të sigurojë qëndrueshmëri, siguri dhe mirëmbajtjen e tyre duke zhvilluar dhe zbatuar procedurat për ruajtjen e shënimeve;
- Mbrojtjen e bazës së të dhënave dhe aplikacioneve nga qasja e paautorizuar, menaxhimin e të drejtave të shfrytëzuesëve;
- Ofron mbështetje në menaxhimin dhe administrimin e bazave të të dhënave;
- Mirëmban bazën e të dhënave dhe aplikacionet ekzistuese dhe siguron integrimin në sistemin e bazës së të dhënave ;
- Zgjidhjen e problemeve tjera teknike në bazat e të dhënave dhe në aplikacionet e MPJD dhe MDK-së;
- Propozon solucione për software adekuat për integrimin në sistemin e bazës së të dhënave;
- Merret me dizajnimin e bazave të të dhënave dhe aplikacioneve varësisht prej kërkesave që vijnë nga njësitet e ndryshme të MPJD dhe MDK-së;
- Kryen edhe pune tjera që ia përcakton mbikëqyrësi i drejtpërdrejt në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat me arsye mund të kërkohen kohë pas kohe dhe të cilat nuk cenojnë dinjitetin e punonjësit.

## 2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

---

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.



### 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a të studimeve universitare: shkenca kompjuterike ose inxhinieri softuerike.
- **Kualifikime të posaçme formale:** Certifikatë të trajnimeve në lëmin TI-së; MCDBA, MCAD, ose MCSA, kanë përparësi.
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

### 4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

---

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

### 5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

---

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

### 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 26/07/2023, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

### 7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

---

- Dt. tentative: 28/07/2023, Rr. "Luan Haradinaj", 10000, Prishtinë, Ministria e Puneve te Jashtme dhe Diasporës



## 8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

---

Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;

Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;

Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;

Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;

Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;

Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

Njohja e gjuhës angleze.

## 9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Intervist

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen



